



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1075/ 10 prot.

Datë 27.05.2025

V E N D I M

Nr. 708/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.05.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.656/2025, datë 14.05.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-42354-03-25-2025 me objekt: “Blerje rrota për kazane”, me fond limit 1,534,500 (një milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 07.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Bajro Bros” shpk me NIPT M113130290 Rruga Ndre Mjeda , Kompleksi rezidencial Magnet, Pallati Lura Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Eco Tirana sha Tirane, Rruga Don Bosko ish parku i autobusave.
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “AIREN” SHPK me NIPT M42411028E Rr. Dritan Hoxha, Nr. Pas. 7/15, Vol.2, ZK. 8210, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 14.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.656/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-42354-03-25-2025 me objekt: “Blerje rrota për kazane”, me fond limit 1,534,500 (një milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 07.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 900/15 prot., datë 23.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1075/7 prot., datë 27.05.2025, autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 656/2025, datë 14.05.2025, si vijon: “.....ju bëjmë me dije se, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e sipërcituar”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën me nr. 900/15 prot., datë 23.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1075/7 prot., datë 27.05.2025, autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 656/2025, datë 14.05.2025, si vijon: “.....ju bëjmë me dije se, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e sipërcituar”.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar nëpërmjet shërbimit postar me shkresën me nr. 900/15 prot., datë 23.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1075/7 prot., datë 27.05.2025, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka rivlerësuar operatorin ekonomik, “AIREN” SHPK në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.656/2025, datë 14.05.2025, duke e skualifikuar këtë ofertues, dhe këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me raportin e auditit të klasifikimit përfundimtar të Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 21.05.2025.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-42354-03-25-2025 me objekt: “Blerje rrota për kazane”, me fond limit 1,534,500 (një milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 07.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

